

VENDIM
Nr. 156, datë 28.9.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË
LLOGARITJES SË TARIFAVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES
SË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16; nenit 20, germa “a”; nenit 108, numër 3 dhe nenit 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të nenit 21, 22 dhe 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.9.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurave për miratimin e “Draftmetodologjisë së llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes të energjisë elektrike”, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve,

konstatoi se,

- Në përmbushje të këtij detyrimi drejtoritë teknike në bashkëpunim me konsulencën e USAID-it kanë përgatitur draftmetodologjinë e llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Drafti i metodologjisë së llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike mbështetet në parimin *price cap*, i njëjtë me metodologjinë ekzistuese të llogaritjes së tarifës (vendimin nr. 79, datë 26 qershor 2008, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s), me disa ndryshime sipas përcaktimeve të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- Ndryshimet e propozuara mbështeten në praktikën dhe eksperiencat e deritanishme të miratimit dhe të rishikimit të tarifave, pa ndryshuar thelbin e metodologjisë ekzistuese, por përmban ndryshime teknike në lidhje me kërkesat për komponentët përbërës të tarifës nisur nga praktika dhe eksperiencia e deritanishme.

- Kjo metodologji citon nevojën e hartimit të formateve standarde të aplikimit, si për tarifën e aksesit po ashtu dhe të përdorimit të rrjetit të shpërndarjes nga FSHU-ja.

- Për përcaktimin e të ardhurave të kërkuara në vitin bazë të periudhës së ardhshme rregullatore, në nenin 7, pika 2, është propozuar që elementeve që figurojnë në metodologjinë aktuale dhe merren në konsideratë për të bërë rregullime/axhustime në të ardhurat e vitit të testimit, t’u shtohet edhe elementi “të ardhura të tjera”. Kjo nënkupton që, përveç sa përmenden në metodologjinë aktuale, ERE do të kryejë axhustime edhe për të ardhurat e tjera, si:

a) të ardhurat nga lidhjet e reja;

b) energjia reaktive;

c) çdo e ardhur tjetër, kur kjo nuk është e pasqyruar në aplikim.

- Hartimi i planeve të investimeve sa më reale e të realizueshme, nëpërmjet mekanizmit të axhustimit të të ardhurave të kërkuara parashikohet që ERE të rishikojë/të korrigjojë tarifat, në rast se OSSH-ja dështon në zbatimin e planit të investimeve.

- Kjo metodologji vendos domosdoshmërinë e alokimit të kostove të energjisë dhe kapacitetit sipas niveleve të tensionit, për të mundësuar përcaktimin e një tarife sa më të drejtë për të mundësuar aksesin e klientëve fundorë në rrjetin e shpërndarjes.

- Është kryer përditësimi i termave të përdorur në metodologji konform përcaktimeve të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- Për energjinë elektrike të përdorur nga klientët, të cilët pikën e livrimit të energjisë elektrike e kanë të ndryshme nga pika e matjes, është parashikuar që në rillogaritjen e tarifës për këtë kategori klientësh të përfshihet humbja që ata shkaktojnë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti